

VENDIM
Nr. 27, datë 30.1.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË HEC LLËNGË SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA: HEC LLËNGA 1, ME FUQI 1730 kw;
HEC LLËNGA 2, ME FUQI 300 kw; DHE HEC LLËNGA 3, ME FUQI 1500 kw, ME
FUQI TOTALE 3530 kw**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”; 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: Llënga 1, Llënga 2 dhe Llënga 3, me fuqi totale të instaluar 3530 kw, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria HEC Llëngë sh.p.k., me shkresën nr. 692 prot. të ERE-s, datë 30.10.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga: HEC Llënga 1, me fuqi 1730 kw; HEC Llënga 2, me fuqi 300 kw; HEC Llënga 3, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 198, datë 24.11.2017, vendosi për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Llëngë.

- Shoqëria HEC Llëngë sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1, të kontratës koncesionare, datë 24.9.2012, të lidhur ndërmjet shoqërisë Istria Sviluppo s.r.l., me cilësinë e koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e autoritetit kontraktues, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 26.5.2010, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC Llëngë.

- Ortak i vetëm i shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. rezulton të jetë shoqëria Energjia Ekologjike sh.p.k., me 100% të kuotave, referuar kjo kontratës notoriale me nr. 420 rep. dhe nr. 221 kol., datë 15.10.2012, të “Shitblerjes së kuotave”. Në përmbushje të detyrimeve të kontratës së sipërpërmendur, shoqëria Istria Sviluppo s.r.l., me cilësinë e ortakut të vetëm, në datën 24.9.2012, ka krijuar shoqërinë koncensionare HEC Llëngë sh.p.k., Me qëllim tjetërsimin e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë koncensionare, në respektim të ligjit për koncensionet dhe të kontratës së koncensionit më sipër cituar, pala shitëse është pajisur me miratimin e transferimit të aksioneve nga ana e autoritetit kontraktues (METE), me shkresën nr. 935/28 prot., datë 5.10.2012. Me vendimin e datës 10.10.2012 të ortakut të vetëm të shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. është vendosur transferimi i 100% të kuotave të kapitalit themeltar që shoqëria Istria Sviluppo s.r.l. zotëron te shoqëria HEC Llëngë sh.p.k., te blerësi Energjia Ekologjike sh.p.k. Në nenin 4 të saj theksohet se: “Shoqëria Istria Sviluppo s.r.l. e humb të drejtën e zotërimit të këtyre kuotave, e drejtë që fitohet nga shoqëria Energjia Ekologjike sh.p.k.”.

- METE, me shkresën nr. 935/28 prot., datë 5.10.2012, drejtuar shoqërisë koncensionare HEC Llëngë sh.p.k., sqaron se miratojmë transferimin e aksioneve në masën 100% me anë të shitblerjes, me kushtin që të ruhet emri i koncensionarit, si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e koncensionit midis METE-s dhe koncensionarit, të cilat i takojnë shoqërisë Istria Sviluppo s.r.l., në të kundërt marrëveshja është e pavlefshme.

Sa më sipër, konfirmimi i njohjes si shoqëri koncesionare të shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. rezulton e konsideruar nga autoriteti kontraktues (METE), në shkresën me nr. 935/28 prot., datë 5.10.2012, me lëndë “Miratim transferim aksionesh”, drejtuar shoqërisë koncesionare HEC Llëngë sh.p.k.

Aplikimi i shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5, germa “a” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Mund të veçojmë këtu shkresën e OSHEE sh.a., “Miratim pike lidhjeje HEC Llëngë sh.p.k.”, me nr. 2740/3 prot., datë 9.3.2017, drejtuar shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k.
- Vendimi nr. 4/7, datë 19.12.2017, i Këshillit Kombëtar të Ujit, për miratimin në parim të lejes së përdorimit të ujit dhe ngarkimi i AUB-së Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi, drejtuar shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k.
- Rezulton e miratuar në parim (neni 9, pika 4.1.5, germa “b”) leja e përdorimit të ujit nga Këshilli Kombëtar të Ujit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë HEC Llëngë sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga: HEC Llënga 1, me fuqi 1730 kw; HEC Llënga 2, me fuqi 300 kw; HEC Llënga 3, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw.

2. Shoqëria HEC Llëngë sh.p.k. të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të lejes së ujit para vënies në operim të veprës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti